



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:086474

Datë: 11.09.2024

Numri i dokumentit: 06147516

C.nr.768/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridiko-civile të paditësit D.N., nga P., të cilin e përfaqëson i autorizuar, Bajrami Lajqi, avokat në Pejë, kundër të paditurës A....(A.), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson A.K., nga P., për shkak të kompenzimit të dëmit në emër të pasurimit të pabazë, vlera e kontestit: 11,758.17€, *pas shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.26.08.2024, në prezencën e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me dt.28.08.2024, merr këtë:*

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TERËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit D.N., nga P., me të cilën ka kërkuar që të:

„OBLIGOHET e paditura A..... që paditësit D.N, t'ia kompensojë dëmin në emër të pasurimit të pa bazë, si në vijim:

a) shumën e konfiskuar kundërligjshëm me Masën për marrje të Pasurisë prej 2,069.00€, nga gjyrollogaria e paditësit, në P., me kamatë ligjore 8% nga dt.06.02.2014, kur është bërë konfiskimi, e gjerë në pagesën definitive.

b) shumën te cilën paditësi është obliguar ta paguaj me këste nga dt.11.03.2014 gjerë me dt.13.10.2014, në lartësi prej 8,316.79€, me kamatë ligjore 8% nga dt.13.10.2014, kur është realizuar pagesa e fundit, e gjerë në pagesën definitive.

c) në emër dëmit material, lidhur me interesin për kredi shumën prej 1,372.38€, me kamatë ligjore 8% nga dt.01.06.2014, datë kur ka filluar pagesa e interesit të kredisë, e gjerë në pagesën definitive, si dhe pagesën e shpenzimeve procedurale, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm”,.

II. OBLIGOHET paditësi D.N., nga P., që të paditurës P...., me seli në Prishtinë, në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë shumën e tërësishme prej 5,050.00€.

A r s y e t i m

Paditësi me padi, (*precizimin dhe rregullimin e padisë në aspektin subjektiv dhe objektiv të bërë nëpërmes parashtrësës së dt.20.02.2024*), gjatë shqyrtimit kryesor e nëpërmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar se paditësi është pronar i Ambulantes Specialistike „...., me seli në P., dhe të njëjtit i është shkaktuar dëme, nga ana e të paditurës, për shkak të pasurimit të pa bazë, dhe baza juridike e kërkesëpadisë mbështetet në faktin se e paditura A..a, ka nxjerrë masën për marrjen e pasurisë, në kundërshtim me nenin 13 par.2 pika 2.1 dhe nenet 20, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, për shkak se e paditura fillimisht e ka ndëshkuar paditësin, dhe pastaj e ka detyruar në pagesën e shumës prej 5,538.31€, për periudhën raportuese 2005-2006, e cila periudhë ka qenë jashtë afateve ligjore të vlerësimit dhe obligimit

të paditësit për të raportuar, andaj, e paditura në kuptim të neneve 13 dhe 20 të ligjit të lartcekur, kundërligjshëm e ka ngarkuar me barrë tatimore paditësin, e pastaj e ka detyruar paditësin në pagesën e kësaj shume, duke i'a bllokuar gjiro llogaritë bankare.

Gjithashtu ka potencuar se baza juridike e kërkesëpadisë, mbështetet në faktin se e paditura ka shkelur edhe nenin 21 dhe 22 të këtij ligji lidhur me nenin 31 të UA Nr. 15/2010, sa i përket periudhës tjetër të vlerësimit 2007-2012 dhe shumës së ndëshkimit për këtë periudhë prej 4,510.67€, sepse nuk i ka dorëzuar paditësit njoftimin e vlerësimit dhe shumën e ndëshkimit brenda 5 dite, pas shtypjes së njoftim-vlerësimit, me çka paditësit i ka mohuar të drejtën e tij për ta kundërshtuar këtë njoftim-vlerësim në shkallë më të larta dhe me e rëndësishmja ky njoftim-vlerësim, kurrë nuk i është dorëzuar paditësit, çka nënkupton se ky njoftim-vlerësim asnjëherë nuk është bërë i formës së prerë.

Se i njëjti lidhur me masën ndëshkimore është njoftuar vetëm pas bllokimit të llogarive bankare, dhe pas konfiskimit të shumës pre 2,063.00€.

Po ashtu e paditura me rastin e nxjerrjes së masës për marrjen e pasurisë, ka shkelur nenin 33 par. 1 të Ligjit nr. 03/ L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat, sepse fillimisht paditësit nuk i është dorëzuar njoftim-vlerësimi sipas nenit 22 të këtij ligji, dhe paditësi fare nuk ka qenë i njoftuar për këtë vlerësim e as për masën e marrjes se pasurisë, pastaj ka vepruar në kundërshtim me par.3 të këtij neni dhe nenit 34 par. 1 dhe 2 të këtij ligji, sepse nuk e ka regjistruar barrën tatimore në Zyrën Komunale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, apo zyrën e regjistrimit të pengut, siç është paraparë me nenin 32 par.3, të Udhëzimit Administrativ nr15/2010, për zbatimin e Ligjit të lartcekur. Dhe po ashtu e paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin 35 par. 1 te Ligjit nr.03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat, lidhur me nenin 35 par.1, dhe nenin 36 par.3 dhe 4 të UA Nr.15/ 2010, sepse veprimet para mbledhjes së detyrueshme të borxhit tatimor janë marr me shkelje ligjore nga nenet e lartcekura, për arsye se e paditura ka qenë e obliguar që para ndërmarrjes së veprimeve të mbledhjes së detyrueshme kundër një pasurie, të regjistrojë barrën e vet tatimore në regjistrat publikë, me qëllim të vendosjes së përparësisë, dhe një gjë të tillë nuk është bërë me çka veprimi i transferimit të mjeteve në shumë prej 2,069.00€, nga P... ka qenë i kundërligjshëm dhe me shkelje të neneve lartcekura, sepse radhën e prioritetit të konfiskimit e ka pasur P..., meqenëse paditësi ishte në marrëdhënie kontraktuale-kredi marrjes me P....

Me veprimet e kundërligjshme të të paditurës të elaboruara më lartë, paditësit i është shkaktuar dëmë material sepse në kohën e bllokimit të gjiro llogarive bankare në muajin janar të vitit 2014, paditësi kishte qenë në marrëdhënie kontratuale të kredisë me P.... dhe po në këtë kohë e paditura lidhur me masën ndëshkimore të kundërligjshme siç u shpjegua me lartë, i'a kishte bllokuar llogarinë bankare dhe me njoftimin për barrë dhe masë për marrje pasurie ka tërhequr nga llogaria e paditësit shumen prej 2,069.00€, edhe përkundër faktit se prioritetin e kishte P..., duke e lënë gjiro llogarinë e paditësit me vetëm 0.88€.

Andaj, paditësi i ndodhur në këtë pozitë ku i ishin bllokuar llogaritë bankare dhe i ishin marr të gjitha të hyrat, në mënyrë që të mos bie në vonesa kamatore, është detyruar që të lidh marrëveshje me të paditurën, për pagesën e masës ndëshkimore, në mënyrë që t'i lirohen llogaritë bankare, për të mos rënë në vonesa të kredisë ndaj P...., si dhe është detyruar që të marr edhe një kredi tjetër në shumë prej 7,200.00 €, për të paguar ndëshkimin nga e paditura edhe pse ky ndëshkim ishte i kundërligjshëm, ku i njëjti për këtë kredi është dashur të paguajë edhe interesin në shumë prej 1,372.38€.

Andaj pas administrimit të provave, dhe dëgjimit të të autorizuarit te paditurës, i autorizuari i paditësit i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e tij në tërësi si e bazuar.

Në fjalën e tij përfundimtare i autorizuari i paditësit ka ripërsëritur se mbesin në tërësi pranë deklarimeve të më hershme duke konsideruar se kjo padi është e bazuar mjaftueshëm, për faktin se e paditura ka obliguar paditësin në pagesën e shumës 538.31€, në kundërshtim me nenin 13 par.2 pika 2.1 dhe nenet 20,21,22, të Ligjit nr.03/L-222, për arsyeje se kjo shumë është jashtë

afateve ligjore të obligimit të paditësit për të raportuar tatimin. Gjithashtu ka cekur se bazaën juridike e kësaj padie e mbështesin edhe në nenin 21 dhe 22, lidhur me nenin 31 të UA 15/2010, për shkak se e paditura, njoftimin ka qenë e obliguar t'ia dorëzoj paditësit në afat prej 5 dite, gjë të cilën nuk e ka bërë, me çka paditësit është mohuar e drejta e ushtrimit të mjetit të rregullt të ankesës, po ashtu konsiderojnë se e paditura njoftimin për marrje të pasurisë e ka marr në kundërshtim me nenin 35 par.1 të Ligjit të lartcekur lidhur me nenin 35,36 par.3 dhe nenin 4 të UA të lartcekur, sepse veprimet para mbledhjes se detyrueshme të borxhit janë marr shkelje nga këtë nene, çka transferimi i mjeteve në shumë prej 2,069.00€ nga P... ka qenë i kundërligjshëm. Sa i përket marrëveshjes të cilën paditësi e ka arritur me të paditurën kjo marrëveshje nuk i plotëson kushtet ligjore për shkak se të njëjtës i mungon vullneti për ta lidhur të njëjtën sepse paditësi duke qenë në marrëdhënie të kredisë me P... e për shkak të bllokimi të llogarive nga e paditura ka qenë i detyruar që të lidhje marrëveshje me të paditurën si parakusht për lirimin e llogarive bankare në mënyrë që i njëjti mos të bijë në vonesa kreditore, për më shumë mbesim në tërësi pranë parashtresës së dt.20.02.2024.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën e tërësishëm prej 10,582.80€, sipas listës së shpenzimeve dhe atë: për përpilim të padisë shumën prej 156€, për taksë gjyqësore shumën prej 21€, për parashtresë për zgjerim objektiv të padisë shumën prej 312€, për parashtresë të dt.08.05.2015, shumën prej 312€, për përfaqësim në seancën e dt.12.05.2015, shumën prej 405,60€, përfaqësim në seancën e shtyre të dt.01.06.2015, shumën 202.50€, për përpilim të parashtresës së dt.06.07.2015, shumën prej 208€, për përfaqësim në seancën e dt.07.09.2015, shumën prej 405.60€, për ekspertizë financiare të dt.23.11.2015, shumën prej 100€, për parashtresë të dt.03.12.2015, shumën prej 312€, për përfaqësim për tri seanca të vitit 2016, nga 405.60€, për një përfaqësim për seancë të shtyrë të dt.01.06.2015, në shumë 202,50€, për tri përfaqësime në seanca të vitit 2016, nga 405,60€, për një parashtresë të dt.24.02.2017, në shumë prej 312€, për 5 seanca të vitit 2017, nga 405,60€, për përpilim të ankesës ndaj aktgjykimit shumën prej 624€, për një seanca të vitit 2021, shumën 405.60€, për përpilim të parashtresës së dt.16.03.2021 shumën prej 312€ për dy seanca të vitit 2021, nga 405,60€, për përpilim të parashtresës së dt.20.02.2024, shumën prej 208€, për përfaqësim në tri seanca të vitit nga 2024,270.40€.

E paditura A..... në përgjigje në padi të bërë me shkrim, gjatë shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se pretendimin e paditësit se A..., fillimisht e ka ndëshkuar paditësin, e pastaj e ka detyruar të paguaj obligimin tatimor, e konsideron të pasaktë, sepse A... nuk e ka ndëshkuar paditësin asnjëherë, por, vetëm ka zbatuar legjislacionin tatimor, neni 13,14 dhe 15 të Ligjit Nr.03/L222 për A..... Tatimore dhe Procedurat, si dhe Kërkesën e Prokurorisë Themelore Departamenti për Krime të Rënda, të cilën sikur të mos e zbatonte do të bënte pengim të hetimeve-përkatësisht vepër penale.

Ka theksuar se nuk qëndron aspak pretendimi i paditësit së A...e ka ndëshkuar atë, sepse është konstatuar vetëm tatimi shtesë pa ndëshkime e interes, për periudhat vlerësuese.

Pretendimi i paditësit se e paditura ka shkelur nenin 21, 22 dhe 31 të Udhëzimit Administrativ 15/2010, sa i përket periudhës vlerësuese, nuk është i bazuar siç u argumentua me lartë, me arsyetim se A...nuk ka kryer kontroll me iniciativë të saj, por vetëm është zbatuar kërkesa e prokurorisë, dhe nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore, si dhe sa i përket pretendimit lidhur me njoftim vlerësimin, që sipas paditësit është dashur t'ia dorëzohet paditësit, mirëpo nuk i është dorëzuar, A...sqaron prapë për gjykatën së ky pretendim është në tërësi i pa bazë, sepse paditësi nuk ka qenë në procedurë kontrolli, por, tatimi është vlerësuar me aktivitet zyrtar (vizitë për mbushëse), lidhur me qarkullimin e padeklaruar nga pasqyrat bankare (llogaritë bankare), informata të cilat Njësia e Krimeve Ekonomike në Pejë (policia), i ka sjellë në A..., dhe pasi që është vlerësuar qarkullimi shtesë i ka rekomanduar, sipas gjykimit me të mirë, që të bëjë deklarin dhe paditësi vullnetarisht ka deklaruar pa kurrfarë detyrimi pra ka kryer „vetëvlerësim" (përmes korrigjimeve të deklaratave tatimore dhe ka pohuar borxhin, duke hyrë

në marrëveshje për pagesën e borxhit tatimor) dhe ka cekur se në këto raste nuk lëshohet njoftim-vlerësim, ngase ekziston në dosjen e paditësit „vetë-vlerësimi" nga paditësi si dhe AU005 i nënshkruar nga paditësi.

Ka cekur se këto terme të përdorura nga paditësi, në padi si dhe në këtë parashtrësë, nuk ka sesi të interpretohen ndryshe përveç si tendencë për të vënë në lajthim gjykatën, sepse nuk ka pasur asnjë detyrim, ngase fjala rekomandim është vetëm këshillë, të cilën paditësi nuk ka qenë i obliguar ta zbattoj, dhe dallon shumë nga detyrimi që në këtë rast nuk ka ekzistuar.

Se A...veprimet e mbledhjes së detyrueshme, i ka ndërmarr në harmoni me ligjin ngase çdo tatimpagues i cili angazhohet në aktivitet ekonomik, ka obligim ligjor që të deklaroj dhe të paguaj tatimin pa kurrfarë kërkesë apo njoftimi, por në mënyrë vullnetare, nëse kjo nuk zbatohet atëherë A... ndërmerr veprimet e mbledhjes së detyrueshme, njëra nga të cilat është edhe bllokimi i llogarive bankare, sepse është e autorizuar me ligj, prandaj edhe ky veprim është ndërmarr në harmoni me ligjin, dhe paditësi i është dorëzuar edhe Përkujtesa për pagesë të vonuar.

Fakt tjetër i cili është në kundërshtim me vet pretendimet e paraqitura në këtë padi (parashtrësë) është edhe Marrëveshja e lidhur nga paditësi me A...-në me vullnetin e lirë të paditësit, për të paguar obligimet tatimore të vet deklaruar, që nënkupton detyrimet e pranuar dhe në anën tjetër të ushtroj padi për pasurim të pa bazë, nuk ka asnjë kuptim sepse kusht për ekzistimin e pasurimit të pa bazë, është rritja e pasurisë së një personi pa bazë ligjore, respektivisht kalimi i pasurisë nga një person të personi tjetër, kur ky kalim nuk bazohet në ligji apo punë juridike, ndërsa në rastin konkret, A... vetëm ka zbatuar ligjin dhe kërkesën e prokurorisë sipas KPRK-së, si dhe ekziston Marrëveshja Nr.1544, mes paditësit dhe A...së, për pagesën e borxheve tatimore, andaj ka theksuar se padia e paditësit duhet të refuzohet.

Po ashtu ka potencuar se paditësi nuk ka vepruar sipas ligjit, neni 30 i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat si dhe neni 41 të U/A 15/2010 për zbatimin e këtij ligji, Kreditimet dhe Rimbursimet, sipas të cilave është rregulluar mënyra e rimbursimit dhe kreditimit të çdo shume të tatimit të paguar mbi shumën e detyrimit tatimor me kërkesën e tatimpaguesit, ndërsa paditësi nuk ka parashtruar këtë kërkesë në A.. sipas procedurave ligjore, neni 30 par. 3 i Ligjit Nr.03/L-222, por direkt ka ushtuar padi në gjykatë pa asnjë bazë ligjore. A.. deklarohet edhe njëherë se qëndron në tërësi pas shkresave të dorëzuara në gjykatë drejtpërdrejtë apo përmes Ministrisë së Drejtësisë, si: Përgjigjes në padi, të dt.23.03.2015; përgjigje në padi, sipas plotësimit të padisë, të dt.05.05.2015; parashtrësën e dt.16.06.2015; Kundërshtimin e ekspertizës financiare, të dt.01.03.2016, si dhe me këtë parashtrësë konsiderojmë se çdo gjë është thënë dhe sqaruar në detaje, prandaj bazuar në faktet dhe dispozitat ligjore, vërtetimin e gjendjes faktike si dhe interpretimin e drejtë të dëshmive, vlerëson se parashtrësja e ushtuar nga paditësi si dhe kërkesëpadia e paditësit, është e pa bazuar dhe nuk përmban pretendime të mbështetura në fakte, por në keqinterpretime të legjislacionit tatimor, ndaj A.. si palë e paditur pa të drejtë në këtë procedurë, kërkon nga gjykata që të refuzojë si të pa bazë kërkesëpadinë e paditësit.

Në fjalën e vet përfundimtare ka ritheksuar se qëndrojnë në tërësi pranë përgjegjës në padi, përgjigjes në parashtrësën e paditësit të dt.20.02.2024, dhe shkresave tjera të dorëzuara në gjykatë dhe theksimeve të deklaruar gjatë seancave, duke konsideruar se përmes këtyre shkresave kanë dhënë sqarimeve të mjaftueshme lidhur me pretendimet e paditësit të cilat i konsiderojnë si të pa bazuara.

Ka theksuar se A...ka ndërmarr veprimet e saj, bazuar në Urdhrin e Prokurorisë Themelore, dhe inicimin nga policia e Kosovës, dhe në bazë të këtyre provave pasqyrave bankare, është vlerësuar sipas legjislacionit tatimore qarkullimi i pa deklaruar ndërsa paditësi ka kryer „vetë vlerësim" duke korrigjuar deklaratat tatimore dhe duke konfirmuar dhe pohuar borxhet tatimore ndaj A..me nënshkrimin e tij në këto deklarata. Se paditësi pastaj ka lidhur edhe marrëveshje me A...-në me vullnetin e tij, për kryerjen e obligimeve tatimore të vetë deklaruar, dhe konsiderojnë se nuk është në rregull dhe nuk ka bazë që në njërin anë të kontraktosh marrëveshje dhe të pohosh borxhin, ndërsa në anën tjetër të ushtrosh padi në gjykatë për pasurim

të pa bazë, sepse në këtë rast nuk kemi të bëjmë me pasurim të pa bazë, nga se paditësi ka paguar detyrimet tatimore të cilat i takojnë sipas ligjit, dhe nëse i referohen gjendjes së tanishme të tatimpaguesit, në A.. figuron se paditësi ka ende borxh të pa paguar. Bazuar në nenin 18 të Ligjit 03/L222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, tatimpaguesi ka të drejtë të bëjë korrigjim të deklaratave tatimore në çdo kohë dhe kjo nënkupton vetë deklarim. Sistemi Tatimor në Kosovë, është sistem vullnetar i deklarimit të tatimit dhe të gjitha bizneset janë të obliguara ligjërisht sipas ligjit, që në mënyrë vullnetare të deklarojnë obligimet e tyre, saktë dhe në përputhje me ligjin, madje me këtë deklaratë ceket „tatim paguesi mban përgjegjësi penale dhe morale për çdo deklaratë”. Nisur nga kjo gjendje faktike A.. i ka propozuar gjykatës që të refuzoj kërkesës padinë e paditësit si të pa bazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e me propozimin e të autorizuarve të palëve ndërgjyqësve ka administruar provat dhe atë: informatën e lëshuar nga A.. me dt.16.07.2013, bashkë me pasqyrën e borxhit total, raportin nga P... të dt.11.03.2014; njoftimin për barrë dhe masa për marrje pasurie (urdhër për transfer) e lëshuar nga A... me dt.28.01.2014, përgjigjen e bankës të bërë me dt.28.08.2014, përkujtesa e parë për pagesë të vonuar e dt.15.04.2006 e lëshuar nga A...; aktgjykimin e GJ.TH. në Gjakovë P.nr..../13, të dt.07.11.2014 dhe i Gj.A. të Kosovës me nr. P.....nr. 612/14 të dt.07.11.2014; 7 fletëpagesat mbi pagesën e kësteve të bëra nga paditësi A...së të krahasuara me origjinalin; procesverbalin penal të dt.15.10.2014; ekspertizën e ekspertit financiar gjyqësor Ukë Sadiku, ecc. i dip. të dt.23.11.2015 dhe deklarimin e tij; ekspertizën e ekspertit financiar gjyqësor Ali Shujaku, ecc. i dip. të dt.20.12.2016; formularët e deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhura personale(deklaratat tatimore të paditësit); vendimi nga Departamenti i Pensioneve, lidhur me pensionin bazik të moshës te dt.15.09.2022, dhe deklarimin e paditësit në cilësi të palës dhe deklarimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në lidhshmëri njëra me tjetrën e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në ri procedurë gjykata ka vlerësuar kërkesën e të autorizuarit të paditësit, për tërheqjen e padisë ndaj të paditurës se dytë P... me seli në Pejë, dhe përfaqësuesi i të paditurës së lartcekur në seancën gjyqësore të dt.16.04.2024, nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e padisë, sipas parashtrës së palës paditëse të dt.20.02.2024, mirëpo i njëjti i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, dhe duke u nisur nga kjo situatë gjykata me aktvendim proceduralë në seancën gjyqësore të dt.26.08.2024 e ka lejuar tërheqjen e padisë ndaj të paditurës se dytë P.....

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi me Aktgjykimin Penal P.nr....13, të dt.07.11.2014, të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, është liruar nga aktakuza për veprat penale: shpërdorim i pozitës zyrtare-autorizimit dhe shmangie nga tatimi për periudhën 2008-2012, i cili aktgjykim është konfirmuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës P.../2014, të dt.07.11.2014.

Nuk është kontestuese se paditësi dhe e paditura kanë bërë marrëveshje për pagesën e obligimeve tatimore të vet deklaruara, me pronar këtu paditësin, e cila marrëveshje mbanë dt.11.03.2014, me ç'rast paditësi i ka pranuar detyrimet tatimore të deklaruara nga ana e tij, përmes korrigjimeve të deklaratave tatimore dhe ka hyrë në marrëveshjen e cekur.

Gjykata në ri procedurë vlerësoi me kujdes provat e administruara, duke u bazuar në gjendjen faktike, dhe duke i marr për bazë edhe sugjerimet e Gjykatës se Apelit të dhëna në Aktvendimin AC.nr..../18, të dt.23.06.2020 dhe të dt.27.10.2020, me çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi edhe përkundër dispozitës së nenit 13 nën paragrafin 2.1 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimor dhe Procedurat (tani ligjë i shfuqizuar), me të cilën obligohet tatimpaguesi që t'i mbajë regjistrat së paku për 6 vite, ka bërë gjegjësisht korigjuar deklaratat tatimore, e që i është mundësuar konform dispozitave ligjore.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale, lidhur me kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e dëmit në emër të pasurimit të pabazë, të cilat i ka pësuar paditësi gjatë zhvillimit të procedurës administrative me të paditurën A....., lidhur me (mos njoftimin, vlerësimin, ndëshkimin dhe masa e marrjes së pasurisë) që kishin të bënin me obligimet tatimore të, me pronar këtu paditësin, gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadia e paditësit nuk ka bazë ligjore, dhe si e tillë është refuzuar në tërësi pasi që A..nuk e ka ndëshkuar paditësin, por vetëm ka zbatuar legjislacionin tatimor, neni 13,14 dhe 15 të Ligjit Nr.03/L222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (tani ligjë i shfuqizuar) si dhe Kërkesën e Prokurorisë Themelore Departamenti për Krime të Rënda.

Gjykata ka konstatuar se A., nuk ka kryer kontroll me iniciativë të saj, por vetëm është zbatuar Kërkesa e Prokurorisë, dhe nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore, dhe nuk e ka ndëshkuar paditësin, por, vetëm gjatë kontrollit është konstatuar tatimi shtesë pa ndëshkime e interes, për periudhat vlerësuese, dhe njoftimi për vlerësim nuk i është dorëzuar paditësit, pasi që i njëjti nuk ka qenë në procedurë kontrolli, por tatimi është vlerësuar me aktivitet zyrtar (vizitë pëmbushëse), lidhur me qarkullimin e padeklaruar nga pasqyrat bankare (llogaritë bankare), informata të cilat Njësia e Krimeve Ekonomike në Pejë, i ka sjellë në A.. dhe pasi që është vlerësuar qarkullimi shtesë i ka rekomanduar paditësit, që të bëjë deklarinimin dhe i njëjti vullnetarisht ka deklaruar pa kurrfarë detyrimi, pra ka kryer „vetëvlerësim“ (përmes korigjimeve të deklaratave tatimore dhe ka pohuar borxhin, duke hyrë në marrëveshje për pagesën e borxhit tatimor).

Gjykata ka vërtetuar faktin se A...veprimet e mbledhjes së detyrueshme, i ka ndërmarr në harmoni me ligjin ngase çdo tatimpagues i cili angazhohet në aktivitet ekonomik, ka obligim ligjor që të deklaroj dhe të paguaj tatimin, pa kurrfarë kërkesë apo njoftimi por në mënyrë vullnetare, nëse kjo nuk zbatohet atëherë A...ndërmerr veprimet e mbledhjes së detyrueshme, njëra nga të cilat është edhe bllokimi i llogarive bankare, sepse është e autorizuar me ligj prandaj edhe ky veprim është ndërmarr në harmoni me ligjin, dhe paditësit i është dorëzuar edhe Përkujtesa për pagesë të vonuar.

Andaj përfundon gjykata se mbështetur në këtë dispozitë nuk kemi pasurim të pabazë ligjore për të paditurën, nisur nga fakti se A.. është e autorizuar për konfiskim pasurie, e në rastin konkret A.. përveç se ka zbatuar legjislacionin tatimor në fuqi ndaj tatimpaguesit, ajo ka zbatuar edhe kërkesën e Prokurorit të Shtetit, të mbështetur në dispozitat e KPRK-së.

Gjykata me rastin e vendosjes, në veçanti është mbështetur në marrëveshjen e paditësit në cilësinë e tatimpaguesit dhe A..-së, që e kanë arritur bashkë, në bazë të së cilës marrëveshje edhe paditësi i ka bërë pagesat për detyrimet tatimore ndaj A..ë, pasi që paditësi për detyrimet e tija tatimore që i ka pasur A...-së, ka pranuar që të njëjtat t'i paguajë, dhe i ka paguar duke hyrë në marrëveshje me A..-në, dhe kjo është dëshmuar me provat-orarin e marrëveshjes së pagesës të dt.11.03.2014, në emër të tatimpaguesit D.N. dhe atë për muajt: mars, prill, maj, qershor, korrik dhe gusht të vitit 2014, si provë tjetër është edhe pagesa e këstit me marrëveshje për muajt e përmendur. Bazuar në këtë kjo gjykatë konsideron se kjo marrëveshje e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës së parë, është lidhur me vullnetin e të dyja palëve e në veçanti me pajtimin e paditësit.

Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit ndaj të paditurës, duke u bazuar në dispozitën e nenit 194 par. 1 të LMD-së, me të cilën shprehimisht është paraparë se „*secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetri, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë, nga tjetri ose ndryshe të kompenzojë vlerën e fitimit të arritur*”. Për të gjetur zbatim kjo dispozitë duhet të ekzistojë (me fjalë të tjera) rritja e aktivitetit gjegjësisht pasurisë në njërin anë apo të ketë zvogëlim të pasurisë në anën tjetër dhe *atë pa bazë ligjore*, e në rastin konkret A..si palë e paditur ka vepruar konform autorizimeve dhe kompetencave të cilat i'a përcakton ligji, konkretisht e njëjta ka vepruar sipas udhëzimeve të Prokurorit të Shtetit nëpërmes Njesisë për Krime Ekonomike në Policisë e Kosovës.

Kjo gjykatë konsideron se në rastin konkret kemi pohim të borxhit nga paditësi, e i cili pohim gjenë mbështetje në dispozitën e nenit 387 të LMD-së, me të cilën shprehimisht është paraparë se „*parashkrimi ndërpritet kur debitori pohon borxhin. Pohimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit por edhe në mënyrë indirekte, siç janë dhënia e kësteve, pagimi i kamatave, dhënia e sigurimit.*”

Andaj në rastin konkret, paditësi nuk mund të kërkojë kthimin, pasi që ka pas dijeni për gjendjen e tij tatimore(*detyrimin tatimor*) dhe përkundër kësaj ka lidhur marrëveshjen e përmendur me të paditurën e parë, andaj duke qenë se pagesa është bërë si rezultat i marrëveshjes, atëherë paditësi nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e kësaj pagese, përveç nëse do të ishte rezervuar e drejta e kërimit të kthimit... (neni 211 i LMD- Ligji i vjetër, gjegjësisht neni 195 i LMD- Ligji i ri),(kjo nënkupton se kthimi i pagesës së bërë varet nga elementi subjektiv i personit që e ka bërë pagesën në rastin konkret paditësi ka pas dijeni për detyrimet e tij tatimore).

Gjykata gjatë vendosjes pati parasysh të gjitha kërkesat dhe pretendimet e palës paditëse, por ato ishin të pa ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muarr konform nenit 452, 453 të LPK-së, ashtu që pala paditëse është e obliguar që të paditurës P..... t'ia paguaj shpenzimet procedurale dhe atë: për përpilim të përgjigjes në padi shumë prej 104€, për përfaqësim në 10 seanca të mbajtura 4,056€ dhe për 4 seanca të shtyra shumë prej 810€, e në shumë të tërësishme prej 5,050€.

Andaj gjykata duke ju referuar të lartcekurave, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.768/20, me dt.28.08.2024.

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kësaj gjykate.